R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 08.03.2022

Dokument parlamentar

(Komision për dhënie mendimi)

R A P O R T

PROJEKTLIGJI

"PËR AKTIN NORMATIV "PER DISA NDRYSHIME (AMENDIMI I TRETE) E TEKSTIN E MARREVESHJES PER PRODHIMIN E FURNIZIMIN, NGA DHE NDERMJET PFIZER EXPORT B. V., MINISTRISE SE SHENDETESISE DHE MBOJTJES SOCIALE TË SHQIPERISE, MINISTRIT TE SHTETIT PER RINDERTIMIN DHE INSTITUTIT TE SHENDETIT PUBLIK, MIRATUAR ME AKTIN NORMATIV NR. 3, DATE 18.01.2021, TE KESHILLIT TE MINISTRA VE, TE NDRYSHUAR"

I. Hyrje

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 07.03.2022, mori në shqyrtim projektligjin "Aktit Normativ Nr. 1, datë 9.02.2022 "Për disa ndryshime (amendimi i tretë) në tekstin e marrëveshjes për prodhimin e furnizimin, nga dhe ndërmjet Pfizer export B.V., Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, miratuar me Aktin Normativ Nr. 3, datë 18.1.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bazuar në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relator Z. Alban Xhelili.

Për të mbrojtur projektligjin në emër të Qeverisë, ishin present:

Nga Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë: Znj. Vjollca Braho Zv. Ministre, Znj. Eugena Tomini, Drejore e Shëndetit Publik, Znj. Antoneta Njehrrena, Drejtore e

Programit të Standartizimit, Harmonizimit të Kuadrit Rregullator pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Punëve Sociale., Z. Gentian Opre, Drejtor i Programimit Buxhetor pranë Ministrisë të Ekonomisë dhe Financës.

II. Baza ligjore Kushtetuese

Akti normativ i Keshillit të Ministrave është në përputhje me Kushtetuten dhe veçanërisht me nenin 101 të saj ku parashikohet se *"Këshilli i Ministrave, në rast nevoje dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, mund të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit për marrjen e masave të përkohshme. Akti normativ i dërgohet menjëherë Kuvendit, i cili mblidhet brenda 5 ditëve, nëse nuk është i mbledhur. Këto akte humbasin fuqinë që nga fillimi, në qoftë se nuk miratohen nga Kuvendi brenda 45 ditëve".* Nevoja dhe urgjenca janë parakushte të domosdorshme për nxjerrjen e një akti normativ.

Pandemia aktuale e shkaktuar nga Sars-Cov-2 (Covid-19) ka shkaktuar dëme të mëdha në shëndetin e njerëzve, duke kaluar deri në humbjen e jetës dhe dëme ekonomike, qoftë për buxhetin e personave të prekur, qoftë për buxhetin e bizneseve, për shkak të vendosjes së masave kufizuesë të frekuentimit të tyre, ashtu si dhe dëme në buxhetin e shtetit, duke kaluar fokusin më të madh në investimet në shërbimet shëndetësore, kryesisht spitalore. Kjo situata e krijuar nga Sars-Cov-2 vlerësohet e pamundur të presë aq kohë sa nevojitet për nxjerrjen e ligjit të nevojshëm nga organi ligjvënës, qoftë edhe nëpërmjet procedurave të përshpejtuara. Nevoja për furnizimin me vaksina anticovid është imediate, pasi domosdoshmëria për të vaksinuar të gjithë popullatën target mbetet ende një emergjencë. Për të gjitha arsyët e përmendura vlersohet se ky akti normativ del pikërisht në kushtet e nevojës dhe të urgjencës, që diktohet nga nevoja për ndryshime të aktit të mëparshëm.

III. Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit

- Qëllimi:

Ky amendim ka si qellim që të përcaktojë sasinë e furnizimit me doza vaksine anticovid Pfizer për vitin 2022. Amendimet percaktojnë rregullat e zbatueshme të vendosjes së produktit në Shqipëri, ndër të tjera, që Kopania Pfizer do të veprojë në përputhje me të gjitha licencat dhe lejet rregullatore qeveritare, si dhe do të veprojë në përputhje me të gjitha praktikat aktuale të prodhimit lidhur me proceset e saj të prodhimit e të paketimit, për të lejuar përmbushjen e detyrimeve të saj sipas këtij ligji. Pfizer do të sigurohët që i gjithë produkti të jetë i etiketuar dhe i paketuar siç duhet, në përputhje me autorizimin, specifikimet dhe standardet e materialeve të praktikave aktuale të prodhimit në fuqi.

Amendimet parashikojnë modalitetet që zbatohën në rast se Shqipëria dëshiron të dhurojë doza kundrejt vendeve të treta. Për këtë të fundit parashikohet se, në rastet kur dozat e kontraktuara të

furnizuara nga kompania Pfizer për blerësin përbëjnë një tepricë të furnizimit mbi kërkesat e blerësit dhe ka jetëgjatësi të përshtatshme për këto doza të teperta, blerësi mundet, në varësi të kushteve, të kryejë një donacion në një vend ose institucion publik (p.sh. COV AX Facility) për produktet që nuk i kalojnë 5% (pesë për qind) të dozave të kontraktuara.

Në vijim të njoftimit të Pfizer-it për ndryshimet e latëpërmendura, me urdhrin nr. 42, datë 20.01.2022, të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, "Per ngritjen e grupit negociator për vlerësimin e kushteve të ndryshimit të marrëveshjes "Per prodhimin dhe furnizimin ndërmjet Pfizer Export B. V. dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik"", u ngrit grupi negociator, i cili diskutoi për ndryshimet e propozuara nga Pfizer Export B. V, si amendament i trete i marrëveshjes bazë. Gjatë negociimit me Pfizer-in u përcaktuan kushtet e meposhtme:

1. Sasia e fumizimit në bazë të përllogaritjes së kryer nga Instituti i Shëndetit Publik.

2. Përkufizimi "Vaksinë pediatrike" lidhur me këtë perkufizim dhe aplikimin e vaksinës në moshat pediatrike iu bë e qartë që duhet të ketë një vendim të Komitetit të Ekspertëve të Imunizimit dhe të Etikës përpara se ajo të përdoret në Shqipëri.

3. Përcaktimi i qartë i ndryshimit/ndryshimeve ndërmjet termit "produkt origjinal" dhe "produkt i adaptuar".

- Përmbajtja:

Akti normativ përmban parashikimet e mëposhtme:

Neni 1 Parashikon miratimin e tekstit te disa ndryshimeve (amendimi i tretë).

Neni 2 Parashikon detyrimet e organeve shtetërore.

Neni 3 Parashikon hyrjen në fuqi.

IV. Vlerësimi i shkallës së përafrimit me Acquis Communautaire

Ky projektligj nuk synon përafrimin me ndonjë acquis të BE-së.

V. Institucionet zbatues

Institucioni përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij akti normativ janë ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Zevëndëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave.

VI. Efektet Financiare

Ky akt normativ shoqerohet me efekte financiare, te cilat do te mbulohen nga buxheti i alokuar per Ministrine e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale per furnizimin me vaksina per vitin 2022.

VII. Shqyrtimi i projektligjit në komision

Përfaqësuesit e Qeverisë bënë një përshkrim të detajuar të marrëveshjes, përshkrimit të projektit si dhe objektivave të synuar që priten nga kjo marrëveshje.

Relatori i Komisionit, në fjalën e tij bëri një përshkrim të projektit duke evidentuar se: Qëllimi i tij është miratimi i disa ndryshimeve në marrëveshjen me kompaninë Pfizer, të cilat do të mundësojnë blerjen e dozave të vaksinës për periudhen 2022- 2023.

Amendimet parashikojnë modalitetet që zbatohën në rast se Shqipëria dëshiron të dhurojë doza kundrejt vendeve të treta. Për këtë të fundit parashikohet se, në rastet kur dozat e kontraktuara të furnizuara nga kompania Pfizer për blerësin përbëjnë një tepricë të furnizimit mbi kërkesat e blerësit dhe ka jetëgjatësi të përshtatshme për këto doza të teperta, blerësi mundet, në varësi të kushteve, të kryejë një donacion në një vend ose institucion publik (p.sh. COV AX Facility) për produktet që nuk i kalojnë 5% (pesë për qind) të dozave të kontraktuara.

Në vijim të njoftimit të Pfizer-it për ndryshimet e latëpërmendura, me urdhrin nr. 42, datë 20.01.2022, të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, "Per ngritjen e grupit negociator për vlerësimin e kushteve të ndryshimit të marrëveshjes "Per prodhimin dhe furnizimin ndërmjet Pfizer Export B. V. dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik"", është ngrit grupi negociator i cili, gjatë negociimit me Pfizer-in u arrit përcaktimi në disa kushtet të cilat janë, - Sasia e fumizimit në bazë të përllogaritjes së kryer nga Instituti i Shëndetit Publik. - Përkufizimi "Vaksinë pediatrike" lidhur me këtë perkufizim dhe aplikimin e vaksinës në moshat pediatrike iu bë e qartë që duhet të ketë një vendim të Komitetit të Ekspertëve të Imunizimit dhe të Etikës përpara se ajo të përdoret në Shqipëri.

Akti normativ shoqerohet me efekte financiare, te cilat do te mbulohen nga buxheti i alokuar per Ministrine e Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale per furnizimin me vaksina per vitin 2022.

VIII. Përfundime

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Ekonominë dhe Financat, pasi vlerësoi se:

Në aspektin ligjor, vlerësoj se projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim, Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, votoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe me shumicën e votave, miratoi atë dhe u shpreh dakord t'i përcillet Komisionit Përgjegjës për vijimin e procedurës sipas Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

RELATOR	**KRYETAR**
Alban XHELILI	**Eduard SHALSI**